

FJALA E MIRËSEARDHJES
KONFERENCA E AUTORITETEVE EVROPIANE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE
PERSONALE
TIRANË, 3-4 MAJ 2018

E nderuar znj. Hysi, Zëvendëskryetare e Kuvendit,
E nderuar znj. Mesi, Zëvendëskryeministre,
I nderuar z. Veliaj, Kryetar i Bashkisë së kryeqytetit,
Të nderuar kolegë,

Në cilësinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Shqipërisë, kam nderin të çel punimet e Konferencës së 28-të të Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Mirëseerdhët në Tiranë.

Këtë vit, më pak se dy muaj më parë, Zyra e Komisionerit mbushi 10 vjet nga dita e krijimit të saj. Një rrugëtim jo i lehtë, por i mbushur me punë dhe vullnet për të krijuar një institucion të konsoliduar e profesional dhe që sot, ka nderin të jetë mikpritësi dhe organizatori i eventit me të rëndësishëm në nivel evropian.

Legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri është bashkëkohor dhe i vendosur në standartet e akteve të Këshillit të Evropës, si dhe të Bashkimit Evropian.

Por aktualisht, në një epokë digjitale, shtrohen përditë çështje që kërkojnë zgjidhje. Kemi një proces dinamik dhe reformues të mbrojtjes së të dhënave personale, procesin e modernizimit të Konventës 108 dhe hyrjen pas disa ditësh në fuqi të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) dhe Direktivës, të cilat kërkojnë angazhim të çdo Autoriteti, por edhe rritjen e koordinimit ndërmjet tyre.

Strategjia e re e Zyrës së Komisionerit e miratuar këtë vit, mbështetet në këtë realitet dhe parashikon detyra dhe objektiva konkretë si:

- Përshtatja e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren 679/2016 e BE (GDPR) dhe Direktivën 680/2016;
- Mbrojtja e të dhënave në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit;
- Edukimi i të rinjve me të drejtat dhe përgjegjësitë e përdorimit të të dhënave personale në ambientet digjitale, etj.

Ne sot këtu jemi të gjithë anëtarë të Konferencës Evropiane, të gjithë anëtarë të Këshillit Konsultativ të Këshillit të Evropës, vende anëtare apo të cilësuar *vende të treta* në raport me GDPR.

Dhe këtu ndoshta duhet të përqëndrojmë më shumë vëmendjen.

Konferenca zhvillohet në Tiranë, në një rajon, atë të Ballkanit Perëndimor, që është i përfshirë vrullshëm në procesin e integritit në BE.

Duke besuar se shpreh vullnetin edhe të vendeve të tjera të rajonit, të përfshira në këtë proces, mendoj se duhet që vullnetit tonë t'i përgjigjen edhe organizmat dhe vendet anëtare të BE, pse jo, për ta bërë mbrojtjen e të dhënave personale, lider në procesin e integritit për ne, dhe të bashkëpunimit sipas GDPR nga ana e vendeve të BE.

Ky vullnet i përbashkët nga të gjithë organizmat, anëtare dhe jo anëtare të BE, do të ishte përgjigja/reagimi ndaj një leximi të drejtë të GDPR, e cila, pikërisht si rezultat i dinamikave që karakterizojnë sot mbrojtjen e të dhënave, i ka kushtuar vëmendje të veçante këtij realiteti, duke e shtrirë efektin e saj të drejtpërdrejtë edhe në vendet jo anëtare të BE, që përpunojnë të dhëna të shtetasve të BE.

Zbatimi i drejtë i dispozitave lidhur me ekstraterritorialitetin do të ishte i vështirë pa bashkëpunimin e organizmave të mbrojtjes së të dhënave dhe vënien në dispozicion të njohurive dhe eksperiencave më të mira ndërmjet tyre.

Në këmbim të njohurive dhe eksperiencave që nevojiten nga Autoritete me më shumë përvojë, ne si vende me rrugëtim më të shkurtër në fushën e mbrojtjes së të dhënave, vendosim vullnetin e mirë për t'iu përgjigjur sfidave dhe kërkesave të kohës në këtë fushë që zhvillohet me hapa të shpejtë.

Kjo do të ishte edhe realizimi i motos së Konferencës:

“Mbrojtja e të dhënave – së bashku më mirë”.

Kam bindjen se Konferenca do t'i shërbejë shkëmbimit të eksperiencave më të mira, rritjes profesionale, unifikimit të praktikës dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave.

Uroj punë të mbarë të punimeve të Konferencës dhe një qëndrim të këndshëm në Shqipëri.